



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 101 / 2020

Datë: 05 / 11 / 2020

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - nr. 07/2020, si dhe nenit 24/B, (paragrafi 4) të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, nxjerr:

### V E N D I M

1. Z.Astrit Gjocaj, emërohet Zyrtar i Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.
2. I emëruari nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores QRK-nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarit në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me datë 05.11.2020 dhe zgjatë deri 31.12.2020 përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
4. Të ardhurat personale të të emëruarit nga pika 1 e këtij Vendimi do të paguhet si pagë primare në vlerë prej 480.00 euro bruto në muaj.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A R S Y E T I M

Duke pas parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që ndalin nga miratimi i udhëzimeve administrative që i parasheh Ligji nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara (Gazeta Zyrtare nr. 27, 31.08.2015), nisur nga fakti se kapacitetet aktuale nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e këtyre detyrave dhe përgjegjësisive, si dhe bazuar në kërkesën e

datës 28.07.2020 për shtim të kapaciteteve në Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- Të emëruarit Z. Astrit Gjocaj;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.